

<b>Tel: +355 4 22 69097</b> <b>+355 4 22 69325</b> <b>Fax:</b> <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b>	<b>UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E</b> <b>SITUATAVE DHE KUSHTEVE TË</b> <b>JASHTËZAKONSHME</b>	<b>Kodi DA-IN-005</b>
		<b>Rishikim nr 1</b> <b>Dt : 21.02.2022</b>
		<b>Faqe 1- 5</b>

## **Udhëzues për menaxhimin e situatave dhe kushteve të jashtëzakonshme**

Zbatuesit: Stafi i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organet e vlerësimit të konformitetit

Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i drejtorisë së laboratorëve testues, kalibrues dhe mjekësorë/Drejtori i Drejtorisë së organeve certifikuese dhe inspektues

Kontrolloi: Menaxheri i cilësisë  
Ardita MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm  
Armond HALEBI

<p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E</b>  <b>SITUATAVE DHE KUSHTEVE TË</b>  <b>JASHTËZAKONSHME</b></p>	<p><b>Kodi DA-IN-005</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 1</b>  <b>Dt : 21.02.2022</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 2- 5</b></p>
---	---	--

## 1. Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të përshkruajë kërkesat dhe të japë udhëzime për menaxhimin e situatave dhe kushteve të jashtëzakonshme nga organet e vlerësimit të konformitetit të akredituar nga DPA.

## 2. Fusha e zbatimit

Ky udhëzues zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, stafi dhe vlerësuesit e saj si edhe nga organet e vlerësimit të konformitetit të akredituar nga DPA sa herë që ka situata dhe kushte të jashtëzakonshme.

## 3. Fjalori

Situatë apo kusht i jashtëzakonshëm nënkupton një rrethanë apo kusht përtej kontrollit të organizatës; zakonisht referohet si “Forca Madhore ose Akt i Zotit”. Shembuj janë lufta, greva, trazira, paqëndrueshmëri gjeopolitike, terrorizmi, krimi, përmbytja, tërmeti, pandemia, hakimi i kompjuterave me qëllim të keq, katastrofa të tjera natyrore ose të krijuara nga njeriu.

## 4. Të përgjithshme

Edhe gjatë situatave dhe kushteve të jashtëzakonshme është e rëndësishme që si DPA ashtu edhe organet e vlerësimit të konformitetit të akredituar prej saj të vazhdojnë të ruajnë dhe të demonstronë përputhshmërinë me kërkesat për akreditim për të siguruar besueshmërinë e produkteve dhe shërbimeve në treg.

## 5. Kërkesa për laboratorët testues, kalibruer, mjekësorë dhe organet inspektuese.

Situatat dhe kushtet e jashtëzakonshme mund të ndikojnë në aftësinë e OVK për të kryer aktivitetet e saj dhe/ose të ruajë pajtueshmërinë me kërkesat e akreditimit. Funkcionimi mund të ndikohet nga reduktimi i orarit të punës, mungesa e stafit, hyrja e kufizuar në blerje dhe shërbime, marrja dhe shpërndarja e mostrave, mbingarkesa në punë, kalibrimi në kohë i pajisjeve, etj. Cdo organ i vlerësimit të konformitetit duhet të vendosë procedurat e tij në lidhje me administrimin e rrezikut duke marrë parasysh sa më poshtë:

- Pezullimi i shërbimit: Nëse OVK është e detyruar të ndërpresë punën për një periudhë të shkurtër kohe që nuk ndikon në ofrimin e shërbimit të tij (psh; nuk asnjë ndikim minimal në kohën e ofrimit të shërbimit), atëherë nuk ka nevojë të informohet DPA. Duhet të mbahen rregjistrimet e cdo rasti ku nuk është respektuar koha e ofrimit të shërbimit dhe

<p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E</b>  <b>SITUATAVE DHE KUSHTEVE TË</b>  <b>JASHTËZAKONSHME</b></p>	<p><b>Kodi DA-IN-005</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 1</b>  <b>Dt : 21.02.2022</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 3- 5</b></p>
---	---	--

duhet të informohet klienti brenda kohës që ishte parashikuar kryerja e shërbimit. Nëse shërbimi duhet të ndërpritet për më shumë se 2 javë, atëherë OVK duhet të informojë DPA.

- Kur OVK mund të vazhdojë ofrimin e shërbimit por i duhet të devijojë nga proceset e zakonshme, duhet të kryhet një rishikim i situatës dhe i risqeve. Ky rishikim duhet të përfshijë të paktën një vlerësim të situatës aktuale dhe asaj të ardhme të OVK. Kur nga rishikimi rezulton një risk i rëndësishëm për mirëmbajtjen e akreditimit, OVK duhet të lajmërojë DPA brenda 2 ditësh nga përfundimi i rishikimit. Në këtë rast OVK duhet të dërgoj në DPA informacionin e mëposhtëm:
  - Fusha e veprimit dhe shtrirja e efektit në shërbimet e OVK, fushat e biznesit, vendndodhja e biznesit dhe statusi i aktiviteteve aktuale;
  - Detaje për cdo veprim alternativ të ndërmarrë ose të planifikuar për të adresuar impaktin;
  - Kur është e nevojshme, plani i veprimit i justifikuar nga OVK për të adresuar cdo devijim të përkohshëm nga kërkesat e akreditimit dhe/ose procedurat e tij\*;
  - Kërkesën për modifikimin e fushës së akreditimit të OVK për të adresuar devijimin;
  - Kur është e nevojshme kërkesa për pezullim vullnetar të pjesshëm ose të gjithë fushës së akreditimit.

Shënim: \*Devijime të përkohshme nga kërkesat e akreditimit dhe/ose procedurat e OVK mund të përfshijë për shembull: vonesa në kryerjen e kalibrimeve periodike dhe kontrolleve të ndërmjetme të mjeteve dhe pajisjeve matëse, përdorimi i furnizuesve alternative që mund të ndikojë në vlefshmërinë e aktivitetit të vlerësimit të konformitetit, pjesëmarrja në PT, nënkontraktimi, kontrolli i brendshëm të cilësisë, auditimet e brendshme dhe rishikimi i brendshëm.

Cdo OVK duhet të mbaj rregjistrime në mënyrë të vazhdueshme për të justifikuar devijimet e ndodhura, impaktin e tyre dhe vendimet e marra nga OVK.

## **6. Kërkesat për trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit dhe personit**

Trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit dhe të personit të akredituar nga DPA duhet të zbatojnë IAF ID 3:2011 “Management of Extraordinary Events or Circumstances Affecting ABs, CABs and Certified Organizations”.

### **6.1 Veprime të përgjithshme**

Për cdo rast certifikimi të ndikuar, organizmi certifikues do të vlerësojë të gjitha risqet e paraqitura për organizatën/personin dhe për certifikimin. Së pari është e nevojshme të vlerësohet shkalla e

<p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E</b>  <b>SITUATAVE DHE KUSHTEVE TË</b>  <b>JASHTËZAKONSHME</b></p>	<p><b>Kodi DA-IN-005</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 1</b>  <b>Dt : 21.02.2022</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 4- 5</b></p>
---	---	--

cdo ndikimi të situatës së jashtëzakonshme në aftësinë e organizatës së certifikuar për të vazhduar të funksionojë në përputhje me kërkesat e certifikimit. Organizmi certifikues duhet të marrë parasysh shtrirjen e ndikimit në organizatën ose personin/produktin e certifikuar dhe të përcaktojë nëse është e mundur që certifikimi të ruhet në rrethanat e jashtëzakonshme. Duhet të mbahen rezultatet e këtij vlerësimi për cdo rast.

Organizmi certifikues i akredituar që lëshon certifikata në fushën e ndikuar duhet të informoj kryevlerësuesin e vet brenda 1 muaji nga shfaqja e situatës së jashtëzakonshme për madhësinë e problemit për të gjitha aktivitetet e akredituara nga DPA. Në vecanti, organizmi certifikues duhet të informojë kryevlerësuesin për cdo rast të ndikuar, që paraqet një risk i lartë në integritetin e certifikatës gjatë periudhës që situata e jashtëzakonshme vazhdon dhe hyrja në zonën e ndikuar nuk është e mundshme. Informacioni do të ishte e mira të përfshijë:

- Fusha dhe shtrirja e shërbimit të ndikuar, zonat e biznesit dhe vendndodhjet;
- Numri i klientëve të ndikuar;
- Kohën kur organizmi certifikues mund të rifillojë të funksionojë normalisht brenda fushës aktuale të akreditimit;
- Cdo metodologji që do të përdoret për mbajtjen e besueshmërisë së sistemit të klientëve të certifikuar gjatë periudhës që është e pamundur të hyjnë në zonën e ndikuar.

## **6.2 Vizitat mbikëqyrëse**

Vizitat mbikëqyrëse duhet të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur pas kalimit të statusit të emergjencës, pas heqjes së kufizimeve për udhëtime në zonat e prekura nga situata e jashtëzakonshme dhe kur bizneset fillojnë të funksionojnë normalisht. Kur është e mundur vizitat mbikëqyrëse duhet të kryhen brenda vitit kalendarik të certifikimit. Vizitat mbikëqyrëse pasardhëse do të ishte e mira të vazhdojnë sipas programit origjinal. Periudhat e zgjatura në kohë ndërmjet dy vizitave mbikëqyrëse mund të kërkojnë organizimin e një vizite mbikëqyrëse shtesë për pjesën e mbetur të ciklit të certifikimit. Në të njëjtën kohë organizmi certifikues do të ishte e mira të përdorte edhe mënyra të tjera monitorimi që mund të jenë: Intervista me telefon, vlerësime online, shqyrtime të dokumentacioneve të dërguara, etj.

## **6.3 Ricertifikimi**

DPA lejon një periudhë maksimale 6 muaj për tejkalimin e auditimeve të ricertifikimit. Nëse është e pashmangshme shtyrja e afatit për auditimin për qellim të ricertifikimit, organizmi certifikues duhet të regjistrojë të gjithë informacionin përkatës, që ka cuar në këtë vendim. Nëse vlerësimi për ricertifikimin nuk mund të kryhet brenda një periudhe 6 mujore, certifikata duhet të pezullohet dhe duhet të kryhet një aplikim dhe vlerësim nga e para.

<p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E SITUATAVE DHE KUSHTEVE TË JASHTËZAKONSHME</b></p>	<p><b>Kodi DA-IN-005</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 1</b>  <b>Dt : 21.02.2022</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 5- 5</b></p>
---	---	--

#### 6.4 Rregjistrimet

Organizmi certifikues duhet të mbajë rregjistrime të plota të të gjithë veprimeve të marra se bashku me vendimet që kanë cuar në këto veprime. Këto rregjistrime duhet të vlefshme në momentin kur DPA do t'i kërkojë.

#### 7. Veprimet e DPA

DPA do të vlerësojë veprimet e propozuara nga OVK, nëse është e nevojshme do të kërkojë informacion shtesë dhe sqarime, në mënyrë që të sigurojë vazhdimësinë e plotësimin të kërkesave të akreditimit. Mbi bazën e informacionit të marrë, DPA mund të modifikojë programin e vizitave mbikëqyrëse dhe riakredituese duke marrë për bazë riskun në lidhje me aktivitetin dhe kushtet e OVK.